



Prishtinë: 28.02.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1119_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1895_12_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **25.01.2018**.

në seancën e mbajtur më datë **28.02.2019**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit G. G. nga Prishtina me shifër të konsumatorit: DPR – 205420 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1895_12_18** i datës 19.12.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 25.01.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori G.G. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se parashtron ankesë për kundërshtimin e tij për borxhin e energjisë elektrike, pra kërkon që t'i falet borxhi i energjisë elektrike për shkak se nuk ka mundësi financiare me i pagu. Konsumatori në ankesë ka theksuar se kërkon nga ZRRE që të merren parasysh gjendje e tij ekonomike dhe sociale pasi është në kushte të vështire ekonomike, pasi që është i pa punë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se ai është i vetdijëshëm që borxhi duhet të paguhet mirëpo gjendja e tij e vështirë financiare e pamundëson një gjë të tillë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit për kundërshtimin e tij për borxhin e energjisë elektrike, pra kërkon që t'i falet borxhi i energjisë elektrike për shkak se nuk ka mundësi financiare me i pagu, Bordi i ZRRE thekson se organi i shkallës së parë e ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe bazuar në të gjitha shkresat e lëndës ka nxjerr vendim që të aprovohet pjesërisht ankesa e konsumatorit G. G. nga Komuna e Prishtinës dhe ka obliguar KESCO që konsumatorit në fjalë t'i



korrigjohen faturat për periudhën maj 2016 dhe gusht 2016 në vlerë -101.08€, duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 09/2014 deri më 08/2016. Pra ZRRE bazuar në kompetencat e veta të dhëna në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë ka shqyrtuar me kujdes ankesën e konsumatorit dhe ka nxjerr vendim, mirëpo ZRRE nuk ka mundur të shqyrtoj diçka që është jashtë kompetencave të veta, mirëpo ka nxjerr vendim bazuar në kompetencat e saja bazuar në legjislacionin primar dhe bazuar në dëshmitë dhe faktet konkrete..

ZRRE ka analizuar listat e leximit të KEDS për periudhën 01/2016 deri më 08/2016 dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka në baza të rregullta mujore ka tentuar të bëjë leximin e shpenzimeve mujore, por që nuk ka pasur qasje në leximin e pikës matës, pasi që në disa periudha mujore nuk kanë pasur qasje në leximin e pikës matëse pasi që njehsori është brenda. Mos qasja e ekipeve të KEDS-it në leximin e shpenzimeve mujore është në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji.

ZRRE e informon gjykatën duke pasur parasysh mos leximin e rregullt të pikës matëse nga ana e KEDS-it, ku në shumë periudha kemi pasur faturim pa matje/paushall e në disa periudha grumbullim të shpenzimit, ka konstatuar se KESCO duhet t'i bëjë një korrigjim konsumatorit në vlerë prej -101.08€ dhe atë duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë për periudhën 09/2014 – 08/2016. Duhet theksuar se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën e shpërndarjes së shpenzimit 09/2014 – 08/2016 është 352.38 kWh/muaj, e që është përafërsisht sa shpenzimi që konsumatori ka shpenzuar për periudhën 01/2010 – 08/2014.

ZRRE gjithashtu e informon gjykatën se ZRRE nuk ka kompetencë që të shlyejë borxhe të energjisë elektrike, pasi që nuk ka asgjë kontestuese dhe këtë e vërteton edhe konsumatori në ankesën tij, edhe përkundër faktit që bashkëndejmë me konsumatorin lidhur me kushtet e vështira ekonomike, mirëpo mendojmë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme dhe duke u thirrur vetëm në kushte të vështira ekonomike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit Gazmend Gashi,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.